



Nr. 374/2 Prot

BASHKIA RROGOZHINË

Rrogozhinë, më 23.01. 2026

Lënda: **Kërkesë për publikim vëndesh të lira.**

Drejtuar: **AGJENCIA KOMBETARE E PUNESIMIT DHE AFTESIVE**

TIRANË

Institucioni Bashkia Rrogozhinë, ka vendosur të shpallë procedurën e konkurimit për 1 pozicion te lirE pune :


- *Personel zjarrëfikës (niveli baze) luftues/shpëtues*

Për këtë arsye, në përputhje me Ligjin nr.152/2015, datë 21.12.2015 "Për shërbimin e mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin" dhe VKM nr.520 datë 25.07.2019 "Për miratimin e rregullores për Shërbimin e Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimin", bashkëlidhur po ju dërgojmë për botim në formë të shkruar dhe elektornike në adresën vendetelirapune@akpa.gov.al

Bashkëlidhur do të gjeni kërkesën përkatëse për publikim.

Duke Ju falenderuar për bashkëpunimin,

KRYETAR
Edison MEMOLLA





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA RROGOZHINË

Nr. ____ prot.

Rrogozhinë më ____ / ____ /2026

NJOFTIM PËR VENDE TË LIRË PUNE PËR PRANIMIN NË NIVELIN BAZË NË SHËRBIMIN E MBROJTJES NGA ZJARRI DHE SHPËTIMIN

Në zbatim të Ligjit nr.152/2015, datë 21.12.2015 “Për shërbimin e mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin” dhe VKM nr.520 datë 25.07.2019 Për miratimin e rregullores për Shërbimin e Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimin Kreu i III “Ndarja e Funksioneve, nivelet, detyrat, procedurat e përzgjedhjes për emërim, lirim pezullim dhe përjashtim”, Njësia e Burimeve Njerëzore në Bashkinë e Rrogozhinës njofton se në Sektorin e MZSH-së shpallen:

1 (një) vend të lirë pune në pozicionin zjarrfikës

- Personel zjarrfikës/Luftues /Shpëtues

1 (një) pozicion (niveli bazë)

Përshkrimi i përgjithshëm i vendit të punës.

Shërbimi i MZSH-së është një strukturë e specializuar e gatishmërisë së përhershme, misioni i të cilës është inspektimi, parandalimi me masat e marra për mbrojtjen nga zjarri, ndërhyrja për shuarjen e zjarreve, shpëtimi i jetës, gjësë së gjallë, pronës, mjedisit, pyjeve dhe kullotave në aksidente të ndryshme, fatkeqësi natyrore, si dhe në ato të shkatuara nga dora e njeriut. Drejtuesi i automjeteve dhe Punonjësi në sallën operuese është personi i emëruar në strukturat e shërbimit të MZSH-së, i trajnuar profesionalisht për të ndërhyrë në shuarjen e zjarreve dhe shpëtimin e jetës së njeriut, të gjësë së gjallë dhe pronës. Duhet të njohë dhe të zbatojë orarin e veprimeve, të dijë pozicionin në shërbim dhe detyrat e tij funksionale, të jetë në çdo kohë në gatishmëri të lartë për të vepruar në zgjidhjen e situatave që ndodhin, të njohë dhe të zbatojë rregullat e brendshme në stacion dhe të sigurojë paprekshmërinë dhe abuzimin e mjediseve, teknikës, paisjeve etj, të mbajë

pastër të gjitha ambjentet që disponon stacioni, të jetë i sjellshëm në komunikim me qytetarët që kërkojnë ndihmë, me kolegët duke pasqyruar një figure qytetare dhe humane.

Kërkesat e përgjithshme për pranimin

- a) Të jetë shtetas shqiptar;
- b) Të ketë zotësi të plotë për të vepruar;
- c) Të jetë në gjendje të mirë shëndetësore dhe i/e aftë fizikisht për të kryer detyra me rrezik të shtuar;
- ç) Të mos jetë i përjashtuar nga shërbimi zjarrfikës, Policia e Shtetit apo nga institucionet e tjera të administratës publike;
- d) Të ketë mbaruar arsimin e mesëm;
- dh) Të mos jetë i/e dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e një vepre penale me dashje;
- e) Të mos ketë rekorde kriminale në organet e policisë dhe prokurorisë (vërtetim personaliteti nga organet e policisë dhe prokurorisë).
- f) Të jetë I moshës nën 30 vjec
- f) Të ketë përfunduar testimin fiziko-profesional dhe kursin përkatës pranë Akademisë së Sigurisë ose në qendra të trajnimit zjarrfikës;
- g) Të jetë me vendbanim sa më pranë stacionit të MZSH-së;
- gj) Për gjininë mashkullore personi duhet të jetë me gjatësi jo më pak se 175 (njëqind e shtatëdhjetë e pesë) cm.
- i) Të jetë me peshë trupore që t'i përgjigjet raportit të gjatësisë.

j) Dokumentacioni , Mënyra dhe Afati i Dorëzimit

Kandidatët duhet të dorëzojnë pranë Sektorit të Burimeve Njerëzore dokumentat si më poshtë

1. Formular aplikimi për pranim në shërbimin e MZSH-së. (Për të marrë formularin e aplikimit klikoni këtu:([Formulari i Aplikimit](#))
2. Fotokopje e kartës së identitetit ;
3. Çertifikatë familjare;

4. Një kopje të jetëshkrimit(CV);
5. Një numër kontakti (e-mail) si dhe adresën e plotë të vendbanimit;
6. Fotokopje deftesë pjekurie;apo diplome.
7. Raport mjeko-ligjor nga autoriteti kompetent, që vërteton “gjëndje të mirë shëndetsore dhe i/e aftë fizikisht për të kryer detyra me rrezik të shtuar”;
8. Vërtetim nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor, si dhe nga Prokuroria e Rrethit Gjyqësor;
9. Vërtetim i gjendjes Gjyqesore (Dëshmi Penaliteti)/ Formular vetëdeklarimi ;
10. Fotokopje të librezës së punës e njësuar me origjinalin (nëse ka);
11. Çertifikata, trajnime profesionale, në fushën e mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin (nëse ka);
12. Dokument i lëshuar nga institucionet shëndetësore që vërteton se nuk është përdorues i lëndëve narkotike.
13. Fotografi (2.5 x 3.5 cm), 2 (dy) cope

Dokumentat duhet të dorëzohen në Sektorin e Burimeve Njerëzore në Bashkinë e Rrogozhinë brenda datës 30.01.2026

Në përfundim të afatit të verifikimit paraprak, Bashkia Rrogozhinë do të shpallë në portalin “Shërbimi Kombëtar i Punësimit”, në faqen e internetit të Bashkisë Rrogozhinë dhe në stendat e informimit të publikut, listën e kandidatëve që plotësojnë kushtet e përgjithshme dhe kriteret e aplikimit, të kërkuara më sipër si dhe për datën,vendin dhe orën e zhvillimit të procedurave .

Kandidatët e skualifikuar kanë të drejtë të ankimohen pranë Njesisë së Burimeve Njerëzore të Bashkisë Rrogozhinë. Afati i ankimimit është 2 (dy) ditë nga data e shpalljes së rezultateve të verifikimit.\

Fusha kryesore mbi të cilën bazohet konkurimi

- Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë

- Ligjin nr.139, date 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore”
- Ligji nr.152, datë 21.12.2015 ‘Për shërbimin e mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin’.
- VKM nr. 520 dt.25.07.2019 “Për miratimin e rregullores për Shërbimin e Mbrojtjes nga Zjarri”.

Mënyra e Vlerësimit të Kandidatëve.

Kandidatët që kualifikohen për të vazhduar procesin e pranimit në shërbimin e MZSH-së u nënshtrohen fazave të konkurrimit, sipas rendit të mëposhtëm:

- a) Testim me shkrim;
- b) Testim i aftësive fizike;
- c) Intervistë me gojë;
- ç) Testimi psikologjik;
- d) Verifikim përfundimtar i aplikantit.

Procedura e konkurimit do të ndjekë këto faza:

- Testimi me shkrim, shërben për të vlerësuar nëse aplikanti zotëron njohuritë dhe aftësitë e nevojshme për kryerjen e detyrave të punonjësit të shërbimit të MZSH-së. Aplikantët që kanë marrë 70% të pikëve të përcaktuara për testin me shkrim, do të njoftohen për të vazhduar procesin e testimit të aftësive fizike.
- Testimi i aftësive fizike, teston aftësitë psiko-motore, ku përfshihen: shpejtësia, shkathhtësia fizike, rezistenca, forca muskulare dhe koordinimi fizik, të domosdoshme për punën e punonjësit të shërbimit të MZSH-së. Aplikantët që kanë marrë mbi 60% të pikëve maksimale vazhdojnë procesin e testimit.
- Intervista me gojë konsiston në testimin e aftësive të aplikantit për të komunikuar qartë, për të shprehur ide dhe koncepte, si dhe për të analizuar e për të marrë vendime.
- Testimi psikologjik konsiston në vlerësimin e aftësive të kandidatit për të reaguar në mënyrën e duhur në kushtet e një stresi minimal;

Rezultati i përgjithshëm i aplikantit përcaktohet si shumatore e rezultatit të testimit me shkrim 50% dhe rezultatit të intervistës me gojë 50%.

Kandidatët fitues do të renditen sipas pikëve të mara dhe përzgjedhja e kandidateve për tu emëruar do të fillojë nga kandidati fitues që ka marë më shumë pikë.

Njësia e Burimeve Njerëzore në Bashkinë Rrogozhinë do të shpallë fituesin në portalin “Shërbimi Kombëtar i Punësimit” në faqen e internetit të Bashkisë Rrogozhinë dhe në stendat e informimit të publikut. Kandidatët jo fitues kanë të drejtë të ankimohen pranë Njesisë së Burimeve Njerëzore të Bashkisë Rrogozhinë. Afati i ankimit është 5 ditë nga data e shpalljes së rezultateve të testimit.

KRYETAR

Edison MEMOLLA